



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë: 27.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **23.06.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Inovix sh.p.k**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së"** – LOT 1,33,34 me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1 nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Pranohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Inovix sh.p.k e dt. 23.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së" – Lot 1,33,34, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 16.04.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. Plotësohet, specifikimi teknik për Lot 1,33,34;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Inovix sh.p.k me datë 27.06.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së" – Lot 1,33,34, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, sot me datë 27.06.2023, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE Plusditamed:**

- Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 28 Specifikimi teknik

#### Pretendimet ankimore:

Kërkese për rishqyrtim kundër dokumenteve të tenderit dhe njoftimit për kontratë Inovix ne pajtim me Nenin 108/A Paragrafi 3 "*Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme*" Pika 1 "*në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave*", parashtron kërkese për rishqyrtim kundër


Njesia e kërkesës- Shkel Nenin 7 dhe 28 te LPP-se (Specifikime teknike favorizuese) Përpilimi i specifikimeve teknike të detyrueshme nga njësia e kërkesës per llot 1 artikujt:

1. Inverted Microscope for ICSI/IMSI with micromanipulator and laser
2. Inverted Microscope for ICSI with micromanipulator
3. Phase contrast binocular microscope with LWD 20x objective
4. Stereo Microscope

Te cilet i jane pershtatur pike per pike vetem prodhuesit Zeiss duke permendur edhe emrat e objektivave te cilet jane te krijuar dhe prodhuar vetem nga ky prodhues si psh:

- Sideport 60N L, 2 pozicione kyçjeje
- Tub dylbi 45°/23 mm
- Faza mekanike 130x85 R/L
- Kornizë për montim xhami të ngrohshëm K Termo pllakë me kontrollues (D)
- Mbulesa e pluhurit
- Ndriçimi i dritës së transmetuar me ndriçues HAL 100
- Bartës për ndriçimin e dritës së transmetuar
- Ndriçues HAL 100 me kolektor kuarci
- Llambë me fije drejtkëndore halogjene afërsisht 12V 100W
- Pajisje optike
- Objektivi LD A-Plan 5x/0.15 M27
- Objektivi LD A-Plan 10x/0.25 iHMC M27
- Objektivi LD A-Plan 20x/0.35 iHMC M27
- Objektivi LD A-Plan 40x/0.55 iHMC M27
- Kondensator LD 0,35 H Ph PlasDIC DIC iHMC
- Moduli iHMC 1 0.35/0.4 për kondensator (10x iHMC)
- Moduli iHMC 2 0.35/0.4 për kondensator (20x iHMC)
- Moduli iHMC 3 0.35/0.4 për kondensator (40x/63x iHMC)
- Mikroskop ndihmës, d=30
- Okular PL 10x/23 Br. fokus.
- Mbyllës okulari
- Përshtatës i kamerës 60N-C 1" 1.0x
- Sistemi i mikromanipulimit dhe injektimit për teknikat ICSI (IVF) dhe transgjenike me manipulues të trashë të motorizuar
- MMO-4 Levë e varur me tri boshte Mikromanipulator hidraulik me vaj
- MM94- Manipulator i drejtimit të motorit
- MM94B- Manipulator i drejtimit të motorit
- IM-21 Lloji i vajit mikroinjektor
- IM-11-2 Lloji i ajrit mikroinjektor
- NZ-19-2 Përshtatës për mikroskop të përmbysur





Edhe pse neve si OE na eshte aprovuar Kerkesa jone per rishqyrtim per te njejtin aktivitet te prokurimit ne te cilen eshte cekur nga AK se do te beje ndryshimet e specifikimeve teknike me sqarime shtese, mirepo praktikisht nje gje e tille nuk eshte bere nga AK, gje qe pamundeson pjesemarrjen e OE te tjere me prodhues me renome Boterore siç jane NIKON dhe Olympus. Pra verehet qartazi se ky llot eshte dedikuar vetem per nje brend, pra ZEISS, dhe si rrjedhojë e e kesaj munesohet keqperdorim i buxhetit te Republikës se Kosoves sepse blerja e ketyre produkteve po behet me vlera stratosferike, pra me çmime shume me te fryera sesa çmimet e tregut.

Njesia e kerkesës- Shkel Nenin 7 dhe 28 te LPP-se (Specifikime teknike favorizuese)  
Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njësia e kërkesës per llot 33 artikullin:

8. Software for IVF laboratory with scan and bar code reader, eshte permendur edhe emri i brandit TupbebeX qe tregon qarte se ky produkt i eshte pershtatur 100% vetem prodhuesit te permendur me poshte.

*Seti i etiketave të informacionit:* Seti i etiketës duhet të printohet me një fjongo (shirit) të veçantë nga printeri i barkodit që do të vendoset në kontejnerët e mostrave (në departamentet e Laboratorit dhe Andrologjisë) që do të përdoret në laborator. Një numër i mjaftueshëm i mostrave të etiketës printohen në setin e etiketës siç mund të kërkohet për një provë. Etiketat mund të printohen lehtësisht nga çdo kompjuter PC, nga ekrani i përkufizimit të Kartës së Pacientit të sistemit softuerik TupbebeX ID. Etiketat janë plotësisht në përputhje me median e inkubatorit. Nga lagështia, lëngjet etj nuk ndikohen nga faktorët.

#### BYZYLYKU I PACIENTI ME ÇIP

Janë rripa dore me çipa RFID, të cilat përdoren në dhomat e operacionit, dhomat e dorëzimit të spermës dhe që vendosen në ditët e trajtimit të pacientit, që përmbajnë trajtimin dhe informacionin e identitetit të pacientit. Në pjesën e përparme të rripit të dorës duhet të shkruhet edhe informacioni i identitetit të pacientit, bashkëshortit, llojit të procedurës, dates së lindjes etj. Gjatësia e byzylykut është 230 mm dhe gjerësia e tij është 27 mm.

#### BYZYLYKU I STAFIT - MBAJTËSE ÇELËSASH OSE KARTË IDENTITETI

Rripat e dorës, mbajtëset e çelësave ose kartat e identitetit janë të përcaktuara / autorizuara për personelin e laboratorit, personelin e sallës së operacionit dhe informacioni i identifikimit të personelit përcaktohet në këto çipa. Identifikimi duhet të bëhet në ekranin e kartave të personelit të sistemit TupbebeX ID. Çdo proces regjistrohet me informacionin e personelit, informacionin e pajisjes, informacionin e datës dhe kohës.

## ABOUT US

### Who Are We?


Our organization, providing computer services and support services for many small- and middle-sized enterprises since 1996, started to produce project-based special software for various sectors under a new organization with a software team formed in 2006. The company entered the health sector in 2010 and started to develop web-Internet projects related to IVF centers in 2011.

With the experience acquired in the health sector since 2010, our firm, which has been carrying out its activities under a new organization titled **DeGoDe Teknoloji Hizmetleri San. ve Tic. Ltd.Şti.**, created **TupBebeX IVF Management Software** in 2012, which is intended solely for IVF Centers. Synthesizing the needs of the IVF sector, our firm created **IVFID Witness System** in 2014, which ensured the safety of all treatment processes and laboratory procedures used in IVF treatments. Our new product came to be used in many centers in a very short time.

**Tank Controls**, which enables the management and tracking of liquid nitrogen tanks where frozen samples (Embryo, Oocyte and Sperm) are preserved, was presented to the sector in 2017. We have expanded our service range with this product that facilitates the work business processes of embryology – andrology laboratories such as 2D mapping of all frozen samples, tracking of occupation rates and time tracking.

The Laboratory Quality Management System titled **IVF TRACK** has been brought into existence as of 2020.

Our firm continues to develop new products with years of knowledge acquired in the IVF sector.



, ndersa artikullit 8 Software for IVF laboratory with scan and barcode reader per prodhuesin IVFID witness system DeGoDe Teknoloji Hizmetleri San. ve Tic. Ltd.Şti., created TupBebeX IVF Management Software,

Ndersa per lot 34 specifikemet teknike per artikullin Nr 9 Incubator (volume 55-70 liters, +/-10%) jane pershtatur pike per pike per produktet e prodhuesit ThermoScientific, ku eshte e pamunder te ofertohet me produkte te prodhuesve te tjere. Kjo bie ndesh me Nenin 28 Paragrafi 2 te LPP-se “Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Gjithashtu ky përpilim teknike nga njësia e kërkesës është diskriminues për te gjitha prodhues tjerë sepse nuk kane mundësi konkurrimi ne raport me kushte teknike te konkurrences/trajtim i barabarte, andaj kjo bie ndesh me RrUOPP, Neni 20 Paragrafi 3” Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit” dhe paragrafi 4 te ketij Neni “Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Gjithashtu bie ndesh me parimin e direktivës se Bashkimit Evropian qe është citat ne RrUOPP,Neni 20



Si pale me interes material për te paraqitur ofertë për këtë aktivitet te prokurimit kërkojmë nga njësia e kërkesës te modifikoj specifikimet teknike te detyrueshme për llot 1 artikujt 1, 2, 3, 4, Lot 33 artikulli nr 8 dhe llot 34 artikulli 9 ne mënyre qe te mundësohet konkurrenca ne mes prodhueseve për produktin qe ju kërkoni/nevojat minimale teknike te konkurrencës, pasi qe kjo është procedure e hapur dhe qëllimi i Autoritetit kontraktues sipas LPP-se është trajtimi i barabarte i OE dhe prodhueseve pjesëmarrës për te arritur qëllimin-Parimin e Ekonomicitetit. Andaj kjo arrihet vetëm kur termat teknike te jene minimal qe përfshijnë disa prodhues ne treg qe te mundësoj konkurrenca maksimale ne mes Operatoreve ekonomik dhe jo kur paraprakisht si ne rastin ne fjalë te dihet se cilin prodhues dhe produkt.

Me kete lloj kufizimi te pjesemarrjes ne kete aktivitet te prokurimit publik, fituesi eshte tanime i paracaktuar te cilit i mundesohet keqperdorimi i buxhetit te Republikes se Kosoves per mbi **400,000 euro** duke u bazuar ne cmimet e tregut dhe top brendet si: Nikon dhe Olympus te cilet jane shume me te specializuar ne fushen e IVF.

### **PROPOZIM**

**TE APROVOHET- Kërkesa për rishqyrtim si e bazuar.**

**Te behet riformulimi i specifikimit teknik per llot 1 duke hapur mundesine per pjesemmarje edhe te OE te tjere duke ofruar brende te njohura boterore.**

Inovix sh.p.k pret përgjigje nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit/njësia e kërkesës ne afat 3 ditësh ne pajtim me Nenin 6 paragrafi 3 te Rregullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.

#### **Dëmet materiale**

Shpenzimet administrativë për këtë tender.

#### **Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE Inovix sh.p.k**

Pranohen pretendimet ankimore te OE për Lot 1,33,34, specifikat plotësohen si me poshtë:

Softueri për laboratorin IVF me lexues skanimi dhe barkodi, komponentët teknikë si:

- RFID CHIP READER - RECORDER
- TABLET PC SYSTEM
- LCD PATIENT INFORMATION SCREENS
- WIRELESS TAGS - RFID CHIPES
- PATIENT BRACELET WITH CHIP
- STAFF BRACELET - KEY RING or ID CARD

Këto grupe komponentësh vijnë në një paketë me një softuer, sasia minimale duhet të përcaktohet dhe përfshihet sipas funksionalitetit të softuerit për ta bërë atë plotësisht operacional dhe funksional.

Softueri mund të jetë COTS (Commercial of the shelf software), por duhet të jetë specifik me porosi, duke mbështetur ndryshimet specifike të klientit pa ndonjë mundësi shtesë.

Komponentët e softuerit dhe harduerit duhet të jenë sipas kërkesave të specifikimeve teknike me të gjitha veçoritë e lidhjes dhe ndërveprimit për të komunikuar dhe shkëmbyer të dhënat ndërmjet njëri-tjetrit.

Sistemi i përgjithshëm duhet të jetë plotësisht operacional dhe funksional në tërësi, pa pasur nevojë për kërkesa shtesë për ndryshime.

Për shkak të ndjeshmërisë së informacionit, duhet të përfshijë një server të dedikuar në lokacionin ku sistemi është në funksion.

Gjuha e softuerit të menaxhimit të zhvilluar duhet të jetë në Anglisht, por duhet të mbështetet dhe të përshtatet lehtësisht në paket e gjuhëve të tjera si Shqipja pa asnjë kërkesë ndryshimi.

Siguria e softuerit duhet të jetë në përputhje me standardet ISO si ISO27001. Softueri duhet të mbështesë autentifikimin e bazuar në përdorues, autentifikimin me 2 faktorë dhe autentifikimin me SMS, gjithashtu të gjitha të dhënat e informacionit personal duhet të ruhen plotësisht të koduara

Softueri i zhvilluar i menaxhimit duhet të mbështesë versionet më të fundit të DB dhe SO. DB dhe SO duhet të jenë sipas kërkesave të softuerit të menaxhimit të zhvilluar, licencat atëherë mund të menaxhohen dhe merren në përputhje me ASHI, por nëse ASHI nuk i ka ose nuk i mbulon të gjitha licencat e kërkuara për shkak të rregulloreve të tyre ose mungesës së licencave, atëherë të gjitha licencat e kërkuara duhet të mbulohen nga furnizuesi.

Dokumentacioni i përgjithshëm i funksionimit dhe përdorimit të sistemit duhet të dorëzohet dhe të ruhet në mënyrë të sigurt në format elektronik pas instalimit të sistemit.

Duhet të jetë i njëjti softuer duke përfshirë tre sisteme (Main Program, ID Witness dhe Tank Kontroll) dhe duhet të jetë i akomoduar në të njëjtin server pa nevojë për server shtesë.

Për Lot 1, 33, 34, ne rast të emrave të mbrojtur të mos merren parasysh, por vlen (ose ekuivalent), ndërsa për specifikat e kërkuara, pranohen të njëjta ose me të avancuara, me qëllim të konkurrencës sa më të gjere në tenderim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

#### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

#### Vendimi i dorëzohet:

1. Inovix sh.p.k
2. Operatoreve ekonomik të interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit